

TË RINJTË DHE INTEGRIMET (II)

NATO dhe BE,
si funksionojnë?

Si funksionon Bashkimi Evropian?


Institucionet kryesore vendimmarrëse të BE-së janë: *Parlamenti Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian dhe Komisioni Evropian*. Ky "trekëndësh institucional" prodhon politika dhe sjell ligje që zbatohen në gjithë BE-në. Në parim, është Komisioni ai që propozon ligjet e reja, por Parlamenti dhe Këshilli i miratojnë ato. Rregullat dhe procedurat për vendimmarrje në BE janë të përcaktuara në Traktate. Çdo propozim për ligj të ri evropian, duhet të jetë i bazuar në nene të caktuar të Traktatit, të referuar si 'bazë ligjore' e propozimit. Kjo përcakton se cila procedurë legjislative duhet të përcillet. Tri procedurat kryesore janë: bashkëvendimi, konsultimi dhe pëlqimi.

Bashkëvendimi. Në procedurën e bashkëvendimit, Parlamenti ndan fuqinë legjislative në mënyrë të barabartë me Këshillin e BE-së. Nëse Këshilli dhe Parlamenti nuk mund të pajtohen për ndonjë pjesë të caktuar të legjislacionit, atëherë nuk do të ketë ligj të ri. Procedura përcakton dy "lexime" të njëpasnjëshme në secilin institucion. Nëse

është arritur marrëveshja në këto lexime, ligji mund të miratohet. Nëse jo, i njëjti do të vihet para Komitetit të pajtimit, i përbërë nga numri i barabartë i përfaqësuesve të Këshillit dhe Parlamentit. Pasi që ky komitet të ketë arritur një marrëveshje, teksti i pajtuar i dërgohet prapë Parlamentit dhe Këshillit në mënyrë që ata ta miratojnë përfundimisht ligjin. Procedura e pajtimit po bëhet gjithnjë e më e rrallë. Shumica e ligjeve të kaluara në procedurën e bashkëvendimit ose miratohen në leximin e parë ose në të dytin, si rezultat i bashkëpunimit të mirë në mes të të tre institucioneve.

Konsultimi. Procedura e konsultimit përdoret në fushat siç janë bujqësia, politika tatimore, konkurrenca, etj. Bazuar në propozimin e Komisionit, Këshilli konsulton Parlamentin, Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve. Në procedurën e konsultimit, Parlamenti mund ta aprovojë propozimin e Komisionit, ta refuzojë atë ose ta kërkojë amendamente shtesë. Nëse Parlamenti kërkon amendamente shtesë, Komisioni do t'i marrë parasysh të gjitha ndërrimet që i sugjeron Parlamenti. Nëse pranon ndonjë nga këto sugjerime, do t'i dërgojë Këshillit një propozim të ndryshuar. Vendimi përfundimisht mbetet tek Këshilli, i cili ose e miraton propozimin e amendamentuar apo e ndryshon atë më tej. Në këtë procedurë, sikur edhe në të tjerat, nëse Këshilli e ndryshon një propozim të Komisionit, atë duhet ta bëjë në mënyrë unanime.

Pëlqimi do të thotë se Këshilli duhet të sigurojë pëlqimin e Parlamentit Evropian para se të merren vendime të caktuara që kanë rëndësi të madhe. Kjo procedurë është e njëjtë si në rastin e konsultimit, përveç që Parlamenti nuk mund të ndryshojë propozimin - ose duhet ta pranojë ose ta refuzojë atë. Pranimi ("pëlqimi") kërkon shumicë absolute në votim. Procedura e pëlqimit më së shpeshti përdoret për marrëveshjet me vendet tjera, përfshirë marrëveshjet që parashohin anëtarësimin e vendeve të reja në BE.



Si funksionon NATO ?

Një nga sekretet për jetëgjatësinë e Aleancës është procesi i saj i vendim-marrjes bazuar në konsensus, që do të thotë se çdo vendim duhet të jetë unanime. Si rezultat shpesh kërkohen konsultime dhe diskutime të zgjatura para se të merren vendime të rëndësishme. Megjithatë ky sistem mund të duket i ngadalshëm dhe i ngathët për një vëzhgues të jashtëm, ai ka dy avantazhe kryesore. Së pari respektohet sovraniteti dhe pavarësia e çdo vendi anëtar. Së dyti, kur merret një vendim, ai ka mbështetjen e plotë të të gjithë vendeve anëtare dhe angazhimin e tyre për zbatimin e atij vendimi.

Konsensusi. Vendimet në NATO merren vetëm me konsensus, d.m.th. në bazë të pajtueshmërisë së përgjithshme. Edhe pse disa anëtare të NATO-s kanë ndikim më të madh politik, ushtarak dhe ekonomik, nuk ka shtrëngim në procesin e marrjes së vendimeve. Kur njëra nga vendet anëtare konsideron se vendimi të cilin NATO shqyrton do të mund t'i shkaktoje dëme sigurisë nacionale të saj, nuk është e obliguar të pajtohet me të. Nëse krijohet një situatë e tillë, vendimi nuk miratohet deri në arrijten se një zgjidhjeje të pranueshme. Për këtë arsye nuk ka sistem votimi, siç është bërë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose *parimi i shumicës së kualifikuar*, si në Bashkimin Evropian. Në vend të kësaj ekziston e ashtuquajtura procedurë e heshtjes (*silence procedure*), e cila nënkupton konsultimet intensive në mes të delegacioneve. Në qoftë së në afatin e caktuar kohor askush nuk e

“ndërpret heshtjen” vendimi miratohet me automatizëm. Në qoftë se njëra nga shtetet anëtare e “ndërpret heshtjen”, kjo nënkupton se vendimi nuk është miratuar.

Konsultimet. Në kuadër të NATO-s konsultimet politike janë pjesë e procesit vital të marrjes së vendimeve. Me rëndësi është të theksohet se në kuadër të NATO-s zyrtarisht nuk ekziston asnjë mënyrë që një vend anëtar t’iu imponojë qëndrimin apo mendimin e vet të tjerave. Rezultat i këtyre parimeve themelore të veprimtarisë së NATO-s është fakti se në rast të mospajtitimit, secila nga vendet anëtare është e lirë të vazhdojë rrugën e vet të zgjedhur të veprimit. Asnjëra nga shtetet nuk është e detyruar të ndërmarrë aksione ose vendime kundër vullnetit të vet. Mirëpo fryma e kompromisit si dhe ndjenja e interesit dhe e qëllimeve të përbashkëta, edhe për kundër dallimeve në mendime, siguron mbështetje të mjaftueshme të përbashkët që të arrihet pajtueshmëria. Vendimi i miratuar i aleancës paraqet qëndrim të përbashkët të të gjitha shteteve anëtare. Çdo shtet anëtar e ka delegacionin e përhershëm në selinë e NATO-s në Bruksel. Konsultimet mund të zhvillohen në forma të ndryshme: mund të jenë shkëmbim i thjeshtë i informatave dhe

mendimeve; procedim i iniciativës apo shqiptim i vendimeve të cilat i ka miratuar qeveria gjegjëse; marrja e qëndrimit, që është në interes për aleatët; njoftimi paraprak mbi veprimet qeveritare apo vendimet për të cilat shtetet tjera anëtare mund të shprehin opinionet ose diskutimi me qëllim të arritjes së konsensusit mbi aktivitetet dhe procedurat të cilat do të duhej ndërmarrë.

NATO ka disa programe bashkëpunimi me shtete anëtare, ndër të cilët mund të veçohen:

Iniciativa e Stambollit për Bashkëpunim (*Istanbul Cooperation Initiative - ICI*), është iniciuar në samitin e NATO-s në qershor të vitit 2004 me qëllim të kontributit afatgjatë të stabilitetit në rajonin e gjerë të Lindjes së Afërt. Ftesa për bashkëpunim në kuadër të iniciativës së Stambollit, para së gjithash iu është dërguar shteteve të Këshillit të Gjirit për Bashkëpunim (*eng. Gulf Cooperation Council - GCC*) të cilën deri sot e kanë pranuar: *Bahrejni, Katari, Kuvajti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.*

Dialogun Mesdhetar (*Mediterranean Dialogue*) - u iniciua në vitin 1994 nga Këshilli Veriatlantik me qëllim të ndërtimit dhe forcimit të mirëbesimit reciprok përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit me shtetet që

nuk janë anëtare të aleancës (Egjipti, Izraeli, Mauritania, Maroku, Tunizia, Jordania dhe Algjeria), për t’i kontribuar forcimit të sigurisë dhe stabilitetit në Mesdhe dhe për të ndikuar në ndryshimin e perceptimit negativ për NATO-n ndër vendet anëtare të Dialogut Mesdhetarë. Ky program bazohet në marrëdhëniet dypalëshe midis secilit vend pjesëmarrës dhe Aleancës. Përbëhet nga dialogu politik dhe nga pjesëmarrja në aktivitetet e që përfshijnë bashkëpunimin në fushën e shkencës dhe të mbrojtjes së mjedisit, të mbrojtjes civile të menaxhimit të krizave, të politikës së mbrojtjes, të kontrollit të kufijve, etj.

Partneriteti për paqe (*Partnership for Peace*) - është programi më i rëndësishëm i NATO-s i orientuar në forcimin e besimit dhe të bashkëpunimit në mes vendeve anëtare të aleancës dhe vendeve partnere, me qëllim të zhvillimit dhe forcimit të stabilitetit dhe sigurisë në rajonin euroatlantik. Esenca e këtij programi janë marrëdhëniet e partneritetit, të modeluara veç e veç midis secilit vend partner dhe NATO-s, të harmonizuara sipas nevojave individuale dhe të realizuara bashkërisht në shkallën dhe ritmin që zgjedh secili shtet që merr pjesë në të.